



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 27 qershor 2019  
Nr. Ref.:RK 1377/19

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**rastin nr. KI167/18**

Parashtrues

**Limak Kosovo International Airport SH.A., "Adem Jashari"**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 273/2018 të 10 shtatorit 2018**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

#### Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga shoqëria aksionare Limak Kosovo International Airport SH.A. "Adem Jashari" (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me seli në fshatin Vrellë, komuna e Lipjanit, e cila përfaqësohet me autorizim nga Fazli Gjonbalaj dhe Leonora Fejzullahu.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 273/2018 të 10 shtatorit 2018.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjyimit të kontestuar, me të cilin sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), si dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 21 shtator 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues) Remzie Istrefi – Peci gjyqtare dhe Nexhmi Rexhepi, në rastin KI128/18.
6. Më 21 shtator 2018, Kryetarja e Gjykatës me Urdhër i bashkoi rastet KI128/18, KI129/18, KI130/18, KI132/18, me të njëjtin Gjyqtar raportues dhe Kolegj shqyrtues si në rastin KI128/18.
7. Më 25 tetor 2018, parashtruesi parashtrroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) dhe rasti ishte regjistruar me numër KI167/18.
8. Më 05 nëntor 2018, Kryetarja e Gjykatës me Urdhër i bashkoi rastet KI128/18, KI129/18, KI130/18, KI132/18, me rastet KI164/18, KI165/18, KI166/18 dhe KI167/18 me të njëjtin Gjyqtar raportues dhe Kolegj shqyrtues si në rastin KI128/18.
9. Më 8 nëntor 2018, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës KI164/18, KI165/18, KI166/18 dhe KI167/18 dhe bashkimin me rastet KI128/18, KI129/18, KI130/18, KI132/18, dhe dorëzoi kopjet e kërkesave të bashkuara në Gjykatën Supreme.

10. Më 4 prill 2019, Kryetarja e Gjykatës me Urdhër ndau rastet e bashkuara KI128/18, KI129/18, KI130/18, KI132/18, KI164/18, KI165/18, KI166/18 dhe KI167/18 në raste individuale, me të njëjtin Gjyqtar raportues dhe Kolegj shqyrtues si në rastin KI128/18.
11. Më 12 prill 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme se rastet KI128/18, KI129/18, KI130/18, KI132/18, KI164/18, KI165/18, KI166/18 dhe KI167/18 janë ndarë me Urdhër dhe se ato do të shqyrtohen individualisht në Gjykatën Kushtetuese.
12. Më 12 prill 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi një shkresë të titulluar “[...]lidhur me lëndët e regjistruara në Gjykatën Kushtetuese DHE në veçanti për lëndën e regjistruar me [...] numër KI132/18”.
13. Më 16 maj 2019, parashtruesi i kërkesës përsëri dërgoi një shkresë të titulluar “Parashtrësë, lidhur me lëndët e regjistruara në Gjykatën Kushtetuese”, në të cilën ai në thelb i përsëriti pretendimet që kishte bërë më parë.
14. Më 27 maj 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve të rastit**

15. Më 12 gusht 2010, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe parashtruesi i kërkesës kishin nënshkruar Marrëveshje të Partneritetit Publiko Privat (në tekstin e mëtejme: PPP). Para nënshkrimit të marrëveshjes së PPP-së, Aeroporti i Prishtinës quhej Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës (në tekstin e mëtejme: ANP).
16. Në bazë të shkresave të lëndës vërehet se punëtori I. A. (në tekstin e mëtejme: punëtori) kishte qenë i punësuar tek ANP-ja. Bazuar në Marrëveshjen e PPP-së, parashtruesi i kërkesës kishte marrë obligim që të gjithë punëtorët t’i mbajë në marrëdhënie të punës edhe për 3 (tri) vite të tjera.
17. Punëtori ka qenë në marrëdhënie të rregullt pune te parashtruesi i kërkesës nga 4 prilli 2011 deri më 3 prill 2014.
18. Më 3 mars 2014, respektivisht 30 (tridhjetë) ditë para skadimit të kontratës, parashtruesi i kërkesës e kishte njoftuar punëtorin se “... në pajtim me politikat e Bordit të Drejtorëve dhe Ligjit të Punës së Kosovës si dhe vendimin për planifikimin e ardhshëm të resurseve njerëzore, të njëjtit nuk do t’i vazhdohet Kontrata e Punës pas datës 03.04.2014”.
19. Më 17 mars 2014, punëtori ka parashtruar ankesë tek parashtruesi i kërkesës “... me propozim që njoftimi i të paditurës për mospërfitje të kontratës së punës i dt. 03.03.2014, të anulohet si joligjor dhe paditësin ta kthejë në vendin e mëparshëm të punës, me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës”.
20. Më 20 mars 2014, parashtruesi i kërkesës me përgjigje refuzoi si të pabazuar ankesën e punëtorit.

21. Punëtori paraqiti kërkesëpadi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), ku kërkoi që të anulohet njoftimi i 3 marsit 2015, si dhe përgjigja e parashtruesit të kërkesës të 20 marsit 2015, të lëshuar nga parashtruesi i kërkesës, dhe të obligohet parashtruesi i kërkesës që të punësuarin ta kthejë në punë me të gjitha të drejtat dhe obligimet, si dhe e obligoi që t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar material.
22. Më 3 korrik 2015, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit (C. nr. 193/14), (i) aprovoi kërkesëpadinë e punëtorit si të bazuar, (ii) anuloi njoftimin e parashtruesit të kërkesës të 3 marsit 2014, si dhe përgjigjen e parashtruesit të kërkesës të 20 marsit 2015 për mosvazhdimin e kontratës së punës (iii) obligoi parashtruesin e kërkesës që ta kthejë punëtorin në të njëjtin vend të punës; (iv) obligoi parashtruesin e kërkesës që punëtorit t'ia paguajë shumën përkatëse në emër të dëmit material; dhe (v) obligoi parashtruesin e kërkesës të mbulojë shpenzimet e procedurës kontestimore.
23. Më 6 tetor 2015, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore (C. nr. 193/14), duke theksuar që aktgjykimi i kontestuar është nxjerrë me shkelje esenciale të dispozitave procedurale, konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.
24. Parashtruesi i kërkesës në ankesën e tij në thelb theksoi se Gjykata Themelore ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike lidhur me kohëzgjatjen e përvojës së punës së punëtorit, duke pohuar se punëtori nuk ka më shumë se 3 vjet përvojë pune, parashtruesi i kërkesës konsideron se për shkak të kësaj gjendje faktike të vërtetuar gabimisht ka ardhur deri zbatimi i gabuar i të drejtës materiale dhe procedurale dhe se aktgjykimi i Gjykatës Themelore është në kundërshtim me nenin 9.18 të Marrëveshjes së Partneritetit Publiko Privat, të nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Aeroporti Ndërkombëtar Limak i Kosovës i 12.08.2010.
25. Më 21 maj 2018, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit (Ac. nr. 3792/2015), kishte refuzuar, si të pabazuar, ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe kishte vërtetuar Aktgjykimin (C. nr. 193/2014) e Gjykatës Themelore, duke e konsideruar të njëjtin si të drejtë dhe të ligjshëm, dhe duke e potencuar se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye konkrete për faktet vendimtare dhe duke dhënë shpjegime adekuate për një vendim të tillë të bazuar në dispozitat përkatëse ligjore.
26. Më 7 qershor 2018, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave procedurale dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesi i kërkesës kishte pretenduar se gjykatat e instancave më të ulëta nuk kishin marrë për bazë nenin 9.18 të Marrëveshjes së PPP-së, sipas së cilës parashtruesi i kërkesës merr për obligim që punëtorët t'i mbajë në punë për 3 (tri) vite. Për më tepër, parashtruesi pretendonte se *“gjykata ka bërë bashkimin e punës nga dy punëdhënës të ndryshëm”*.

27. Më 10 shtator 2018, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin (Rev. nr. 273/2018), refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës, duke arsyetuar se “...në mënyrë të plotë gjendjen faktike drejt ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar. Aktgjykimi i goditur nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat kjo Gjykatë i vlerëson sipas detyrës zyrtare. Gjykata e shkallës së dytë në arsyetimin e aktgjykimit ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet relevante për gjykim të drejtë të kësaj çështjeje-juridike të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë, kështu që pretendimet në revizion nuk e vejnë në pyetje ligjshmërinë e aktgjykimit kontestues“.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

28. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se “Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin Rev. nr. 273/2018, [...], ka shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], për shkak të mos arsyetimit të vendimit gjyqësor, duke pohuar me tej se “si pasojë e mungesës së arsyetimit, vendimi i kontestuar e privoi Parashtruesin e kërkesës nga e drejta kushtetuese për mjet efektiv juridik” dhe me këtë atij i është shkelur edhe e drejta e garantuar me nenet 32 dhe 24 [Barazia para ligjit]; si pasojë e këtyre shkeljeve, parashtruesit i është cenuar edhe e drejta e pronës sipas nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës. Parashtruesi pohon gjithashtu, se ka shkelje te nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] i KEDNJ-së.“
29. Parashtruesi i kërkesës në thelb arsyeton pretendimin e tij duke theksuar se gjykatat e rregullta kanë vërtetuar gabimisht gjendjen faktike dhe se ka ardhur deri te aplikimi i gabuar i të drejtës procedurale dhe materiale, duke theksuar se vendimet e gjykatave të rregullta nuk kanë arsyetuar në masë të mjaftueshme si në vijim:
- (i) Se gjykatat e rregullta kanë vërtetuar gabimisht gjendjen faktike lidhur me kohëzgjatjen e përvojës së punës të punëtorëve, duke pretenduar se punëtori nuk ka më shumë se 3 vjet përvojë pune.
  - (ii) Se parashtruesi i kërkesës ka pasur të drejtë që me njoftim ta ndërprente marrëdhënien e punës e tij në pajtim me kontratën e punës, nenin 1.1 dhe nenin 67 paragrafi 1.3, si dhe nenin 71 paragrafi 2 të Ligjit të punës nr. 03/L-212.
  - (iii) Se gjykatat e rregullta kanë interpretuar gabimisht nenin 10.5 të Ligjit të punës nr. 03/L-212, sepse ai nuk mund të zbatohet për ndërmarrjen Limak, meqë punëtori nuk ka dhjetë (10) vite përvojë pune të vazhdueshme me të paditurin.
  - (iv) Se gjykatat e rregullta nuk kanë marrë parasysh nenin 9.18 të Marrëveshjes së PPP, sipas së cilës parashtruesi i kërkesës merr përsipër detyrimin për të mbajtur punëtorët në punë brenda 3 (tre) viteve.
30. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu citon Aktgjykimin KI138/15 të Gjykatës Kushtetuese dhe pohon se “aplikimi i të drejtës materiale që mund të ishte fakt, ishte përcaktuese për marrjen e aktgjykimit të asaj gjykate, porse Gjykata

Supreme nuk e adresoi fare këtë çështje dhe vetëm konstatoi që gjykatat e shkallëve më të ulëta në mënyrë të drejtë kanë zbatuar dispozitat e ligjit material”.

31. Parashtruesi i kërkesës kërkon që “Gjykata Kushtetuese duhet të vlerëson nëse procesi gjyqësor në tërësinë e tij ka qenë i drejtë dhe i paanshëm, ashtu sikur edhe kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës (shih, ndër të tjera, mutatis mutandis, Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, 16 dhjetor 1992, f. 34, seria A. nr. 247, dhe B. Vidal kundër Belgjikës, 22 prill 1992. f. 33, seria A. nr. 235).
32. Parashtruesi i kërkesës, kërkon që Gjykata ta shfuqizojë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, dhe që çështjen ta kthejë në rigjykim.

## **Dispozitat përkatëse ligjore**

### **Ligji Nr. 03/L-212 i Punës**

#### *Neni 10*

#### *Kontrata e Punës*

*[...]*

5. Kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vite, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore.

#### *Neni 67*

*[Ndërprerja e Kontratës së Punës sipas fuqisë ligjore]*

1. Kontrata e Punës sipas fuqisë ligjore, ndërpritet:

*[...]*

1.3. me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës;

#### *Neni 70*

*[Ndërprerja e Kontratës së Punës nga ana e punëdhënësit]*

1. Punëdhënësi mund t’ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit me një periudhë paralajmërimi, atëherë kur:

1.1. ndërprerja e tillë arsyetohet për arsye ekonomike, teknike ose organizative;

1.2. i punësuarit nuk është më i aftë t’i kryejë detyrat e punës;

1.3. punëdhënësi mund ta ndërpresë kontratën e punës në rrethanat e përcaktuara në nënparagrafin 1, 1 dhe 1, 2 të këtij paragrafi nëse është e papërshtatshme për punëdhënësin që ta transferojë të punësuarin në një vend pune tjetër, ta trajtojë a ta kualifikojë atë për ta kryer punën ose ndonjë punë tjetër;

1.4. punëdhënësi mund t’ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit në periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes në 1.4.1. rastet e rënda të sjelljes së keqe të punonjësit; dhe 1.4.2. për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës.

1.5. punëdhënësi duhet ta njoftojë të punësuarin për largimin e tij/saj menjëherë pas rastit që shpie në largim, ose sapo punëdhënësi të jetë vënë në dijeni të atij rasti;

1.6. punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit pa periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes, atëherë kur:

1.6.1. i punësuarit është fajtor për përsëritjen e një keqsjelljeje më pak serioze ose të shkeljes së detyrimeve; 1.6.2. performanca e të punësuarit mbetet e pakënaqshme përkundër paralajmërimit me shkrim.

2. Punëdhënësi mund ta ndërpresë kontratën e punës në bazë të nënparagrafit 1.6. të paragrafit 1. të këtij neni vetëm atëherë kur i punësuarit ka marrë përshkrimin në formë të shkruar të performancës së pakënaqshme, një afat të përcaktuar kohor brenda të cilit i punësuarit duhet ta përmirësojë performancën e vet, si dhe një deklaratë se dështimi për përmirësimin e performancës do të rezultojë me largim nga puna pa asnjë paralajmërim të mëtejshëm me shkrim.

#### Neni 71

[Koha e njoftimit për ndërprerjen e kontratës së punës]

1. Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës në kohë të pacaktuar në bazë të nenit 70, të këtij ligji në këto intervale kohore të njoftimit:

1.1. prej gjashtë (6) muaj deri në dy (2) vite punësim, tridhjetë (30) ditë kalendarike;

1.2. prej dy (2) deri në dhjetë (10) vite punësimi, dyzetepesë (45) ditë kalendarike;

1.3. mbi dhjetë (10) vite punësim, gjashtëdhjetë (60) ditë kalendarike.

2. Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës për kohë të caktuar me njoftim prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike. Punëdhënësi i cili nuk ka për qëllim të ripërtërijë kontratën me periudhë të caktuar duhet të informojë të punësuarin së paku tridhjetë (30) ditë para skadimit të kontratës. Dështimi për ta njoftuar nga punëdhënësi, do t'i japë të drejtën të punësuarit për zgjatjen e tridhjetë (30) ditëve kalendarike shtesë me pagë të plotë.

### **Marrëveshja për Partneritet Publiko privat për Operimin dhe Zgjerimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës**

#### **9.18 [Përfundimi i Personelit]**

„Partneri Privat mund të përfundoj punësimin ose ndonjë angazhim të çfarëdo punëtori të ANP (i) në çdo kohë për çështjet në lidhje me ligjet, rregullat, dhe rregulloret administrative dhe dekretet e aplikuar (ii) sipas marrëveshjes së përbashkët, dhe (iii) pa kufizime pas përvjetorit të tretë (3) të datës së hyrjes në fuqi“.

#### **Pranueshmëria e kërkesës**

33. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

34. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

35. Gjykata po ashtu i referohet paragrafit 4, të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, që përcakton:

*“4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.”*

36. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqes ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejné për individët dhe personat juridikë (shih: rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI41/09, parashtruesi i kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, par. 14).

37. Në vazhdim, Gjykata vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 47 [Kërkesa Individuale], nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

#### Neni 47

[Kërkesa individuale]

- 1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*
- 2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*

#### Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.*

#### Neni 49

[Afat]

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. [...]*



38. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi është palë e autorizuar, i cili konteston aktin e një autoriteti publik, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur përmes këtyre vendimeve, në pajtim me kushtet nga neni 48 i Ligjit, dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
39. Megjithatë, Gjykata duhet të vlerësojë më tej nëse janë plotësuar kriteret e parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, duke përfshirë kushtin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Kështu, rregulli 39 (2), i Rregullores së punës, përcakton:
- (2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështet në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.*
40. Gjykata së pari vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se i është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, sepse vendimet e gjykatave të rregullta nuk janë të arsyetuara në mënyrë të mjaftueshme, përderisa shkeljet e të drejtave të tjera të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ i pretendon si rezultat i shkeljes së të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.
41. Në thelb, parashtruesi i kërkesës e arsyeton kërkesën e tij duke përsëritur të njëjtat pretendime që ai i ka paraqitur edhe në gjykatat e rregullta në lidhje me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimin e gabuar të së drejtës procedurale dhe materiale, duke theksuar se vendimet e gjykatave të rregullta nuk kanë arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme si në vijim:
- (i) Se gjykatat e rregullta kanë vërtetuar gabimisht gjendjen faktike lidhur me kohëzgjatjen e përvojës së punës të punëtorëve, duke pretenduar se punëtori nuk ka më shumë se 3 vjet përvojë pune.
  - (ii) Se parashtruesi i kërkesës ka pasur të drejtë që me njoftim ta ndërprente marrëdhënien e punës së tij në pajtim me kontratën e punës, nenin 1.1 dhe nenin 67 paragrafi 1.3, si dhe nenin 71 paragrafi 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212.
  - (iii) Se gjykatat e rregullta kanë interpretuar gabimisht nenin 10.5 të Ligjit të punës nr. 03/L-212, sepse ai nuk mund të zbatohet për ndërmarrjen Limak, meqë punëtori nuk ka dhjetë (10) vite përvojë pune të vazhdueshme me të paditurin.
  - (iv) Se gjykatat e rregullta nuk kanë marrë parasysh nenin 9.18 të Marrëveshjes së PPP, sipas së cilës parashtruesi i kërkesës merr përsipër detyrimin për të mbajtur punëtorët në punë brenda 3 (tre) viteve.
42. Gjykata do të vlerësojë kushtetutshmërinë e vendimeve të kontestuara të gjykatave të rregullta në lidhje me pretendimin e parashtruesit se vendimet e gjykatave të rregullta nuk janë arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme dhe i referohen secilit pretendim individual të parashtruesit.

43. E para, sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës (i) se gjykatat e rregullta kanë vërtetuar gabimisht gjendjen faktike lidhur me kohëzgjatjen e përvojës së punës të të punësuarve duke pretenduar se punëtori nuk ka më shumë se 3 vjet përvojë pune.
44. Lidhur me këto pretendime të parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se Gjykata Themelore arsyetoi se *“Mbi bazën e gjendjes faktike të vërtetuar nga provat e administruara si më lartë, e të cilave gjykata në tërsi ua fali besimin, është vërtetuar se paditësi tek paraardhësja e të paditurës ANP "Adem Jashari" sh.a, ka themeluar mardhënje pune që nga dt. 01.00.2002 dhe tek e njëjta ka punuar pandërprer deri më 03.04.2011, ndërsa që nga 04.04.2011, e deri më 03.04.2014, në mënyrë të pandërprer ka punuar tek e paditura dhe me këtë ka plotsuar mbi 10 vite pune të pa ndërprerë tek paraardhësja e të paditurës dhe tek e paditura, e bazuar në dispozitën e nenit 10.5 të Ligjit të Punës, gjykata erdhi deri tek përfundimi se kontrata e punës në kohë të pa caktuar tek e paditura, konsiderohet kontratë pune në kohë të pacaktuar, andaj gjykata konsideron se në këtë situatë, e paditura për me ja shkëput mardhënjen e punës në kohë të pa caktuar paditësit, ka qen i obliguar që të udhëheq procedurë të mbrendëshme për ndërprerje të mardhënjes së punës, procedurë kjo e cila nuk është udhëhequr tek e paditura, por paditësi vetëm është njoftuar me njoftimin për mospërtrritjen e kontratës së punës “.*
45. E dyta, sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës (ii) se parashtruesi ka pasur të drejtë ta ndërprejë marrëdhënien e punës me njoftim në pajtim me kontratën e punës, nenin 1.1 dhe nenin 67 paragrafi 1.3 dhe nenin 71 paragrafi 2 të Ligjit të Punës. 03/L-212.
46. Lidhur me këto pretendime të parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se Gjykata Themelore së pari konkludoi se *“... njoftimi i të paditurës për mospërtrritjen e kontratës së punës paditësit, pa zhvilluar asnjë procedurë të mbrendëshme për ndërprerje të mardhënjes së punës është jo ligjor“.*
47. Me të njëjtin aktgjykim, Gjykata Themelore arsyetoi më tutje se kur dhe nën cilat kushte punëdhënësi mund ta shfrytëzojë këtë mundësi, duke arsyetuar në detaje se cilat masa ligjore të mëparshme duhet të ndërmerren, duke theksuar se *“...eventualisht nëse ndërprerja e mardhënjes së punës ka të bëjë me arsye të teknike, ekonomike ose organizative, conform dispozitave të 70 e lidhur me n. 76 të Ligjit të Punës, e paditura ka qen e obliguar të harton program me shkrim si dhe ti zbatojë këto dispozita të LP-es, dhe përveç që ta njoftoj paditësin një muaj para se të ia ndërpret mardhënjen e punës, ka qen e obliguar edhe ta njoftoj sindikatën e të punësuarit lidhur me ndryshimet e planifikuara, duke bërë përpjekje paraprakisht të risistemimit e mbrendëshëm të të punësuarve, kufizimit e orëve jashtë orarit të punës, zvoglimin e orëve të punës së puntorëve, ofrimin e riaftësisimit profesional dhe masat tjera të përcaktuara me ligj, masa këto të cilat asnjëherë prej këtyre nuk e ka bërë e paditura, përkatësisht deri në përfundimin e procedurës në shkallë të parë nuk ka ofruar prova se ka vepruar diçka në këtë drejtim...“.*
48. Gjithashtu, lidhur me këto pretendime të parashtruesit të kërkesës, Gjykata e Apelit iu përgjigj në mënyrë të detajuar kur i refuzoi si të pabazuara *“...pretendimet ankimore se prej momentit të nënshkrimit të Marrëveshjes në*

*mes të Qeverisë së Kosovës dhe të paditurës, paditësi nuk ka më tepër se 3 vite përvojë pune, për faktin se me provat e administruara është vërtetuar se paditësi në të njëjtin vend pune, punon më tepër se 10 vite dhe se Kontrata e tij e punës në kuptim të nenit 10 paragrafi 5 të Ligjit të Punës konsiderohet si kontratë për një periudhë të pa caktuar kohore, kështu që paditësit nga ana e të paditurës do të mund ti ndërpritej marrëdhënia e punës vetëm nëse do të plotësoheshin kushtet e përcaktuara me dispozitën e nenit 70 të Ligjit të Punës, e kurrësi në bazë të nenit 67 paragrafi 1 dhe 3 të këtij ligji, ku thuhet se kontrata e punës sipas fuqisë ligjore, ndërpritet me skadimin e kohëzgjatjes së punës...*

49. E treta, lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës (iii) se gjykatat e rregullta kanë interpretuar gabimisht nenin 10.5 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, sepse ai nuk mund të zbatohet për ndërmarrjen Limak, meqë punëtori nuk kishte dhjetë (10) vite përvojë pune të pandërprerë me të paditurën.
50. Gjykata vëren se Gjykata e Apelit arsyetoi se “... pretendimet ankimore të autorizuarit të paditurës lidhur me atë se aktgjykimi i atakuar është rrjedhojë e konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike janë të pabazuara dhe të paqëndrueshme me arsyetimin se gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave të ofruara nga palët ndërgjyqëse dhe vlerësimit të tyre, ka marrë aktgjykimin e atakuar, i cili, është i drejtë dhe i ligjshëm, nga se në të janë dhënë arsyet konkrete për faktet vendimtare dhe ka ardhur në përfundim se paditësi mbi bazën e kontratës së punës ka punuar te e paditura më tepër se 10 vite pa ndërprerë, ashtu që në kuptim të dispozitës së nenit 10.5 të Ligjit të Punës paditësi e ka fituar statusin juridik ligjor të punësuarit në kohë të pa caktuar. Në rastin konkret nuk merren parasysh faktet ligjore të Marrëveshjes për Partneritet Publiko Privat siç pretendohet nga e paditura, nga se në situatën konkrete konform dispozitës së nenit 4 par. 3 të Ligjit të Punës, nuk zbatohet marrëveshja e tillë, por zbatohet Ligji në fuqi i cili është më i favorshëm për punëtorin. Prandaj, në këtë situatë faktike, marrëveshja e tillë e të paditurës, nuk zbatohet“.
51. E katërta në lidhje me pretendimin e parashtruesit (iv) Se gjykatat e rregullta nuk kanë marrë parasysh nenin 9.18 të Marrëveshjes së PPP, sipas të cilës parashtruesi i kërkesës merr detyrimin për të mbajtur punëtorët në punë brenda 3 (tre) viteve.
52. Gjykata vëren se Gjykata Supreme e ka arsyetuar se “... janë të paqëndrueshëm pretendimet përkitazi me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, të cilat sipas arsyetimit nga revizioni qëndrojnë në atë se, aprovimi i kërkesëpadsisë së paditësit për kthimin në punë është në kundërshtim me nenin 9.18 të Marrëveshjes për Partneritetin Publik Privat të lidhur mes të paditurës dhe Republikës së Kosovës, 12.08.2010, kjo për arsye se, në këtë dispozitë të kësaj marrëveshje, parashihet që partneri privat këtu e paditura mund të përfundoj punësimin ose ndonjë angazhim të çfarëdo punëtori të ANP-së, në çdo kohë për çështjet në lidhje me ligjet, rregullat dhe Rregulloret administrative dhe deklaratat e aplikuara sipas marrëveshjes së përbashkët dhe pa kufizime, pas përvjetorit të tretë të hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje. Mirëpo nga kjo dispozitë rezulton se, nuk parashihet ndërprerja

*e kontratave të ngjashme të punësimit, sikur tek rasti i paditësit në kundërshtim me ligjet ekzistuese në Kosovë”.*

53. Gjykata më tej rikujton që parashtruesi i kërkesës, gjithashtu thirret në Aktgjykimin KI138/15 të Gjykatës Kushtetuese, duke pohuar se “aplikimi i të drejtës materiale që mund të ishte fakt, ishte përcaktuese për marrjen e Aktgjykimit të asaj gjykate por se Gjykata Supreme nuk e adresoj fare këtë çështje dhe vetëm konstatoi që gjykatat e shkallëve më të ulëta në mënyrë të drejtë kanë zbatuar dispozitat e ligjit material”.
54. Lidhur me këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës, Gjykata rikujton se rasti në fjalë dallon nga rasti para nesh për arsyet si në vijim: (i) çështja e procedurës disiplinore ndaj punëtorit të parashtruesit në atë rast ishte trajtuar në mënyrë të ndryshme nga gjykatat e rregullta; (ii) ishte e paqartë baza juridike me të cilën është zhvilluar procedura disiplinore; dhe (iii) kishte elemente kontradiktore në vendimet e gjykatave të instancave më të ulëta. Për më tepër, Gjykata e Apelit kishte zbatuar dhe kishte përdorur për arsyetim një Udhëzim Administrativ i cili zbatonte një Rregullore për shërbyesit civilë, e jo Ligjin e Punës. Ky argument edhe pse ishte i ngritur nga parashtruesi i kërkesës në atë rast, nuk ishte shqyrtuar nga Gjykata Supreme (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI138/15, *Sharr Beteiligung GmbH*, Aktgjykim i 4 shtatorit 2017).
55. Gjykata së pari thekson se nuk është funksioni i saj të merret me gabimet e gjendjes faktike apo aplikimin e gabuar të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç nëse gabimet dhe zbatimi i gabuar i ligjit nuk janë të tilla që shkelin të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë ( shih rastin e GJEDNJ-së, *Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999,paragrafi 28) .
56. Megjithatë, para së gjithash është detyrë e gjykatave të rregullta t'i zgjidhin çështjet e interpretimit të rregullave të brendshme ligjore. Kjo veçanërisht vlen për interpretimin e të drejtës procedurale nga ana e gjykatave (shih rastin e GJEDNJ-së *Pekinel kundër Turqisë*, nr. 9939/02, 18 mars 2008, paragrafi 53,). Roli i Gjykatës është vetëm të përcaktojë nëse efektet e interpretimit të tillë janë në pajtim me Kushtetutën në tërësi dhe me parimin e sigurisë juridike, të garantuara veçanërisht me nenin 6 të KEDNJ-së.
57. Gjykata përsërit se neni 6 i KEDNJ-së dhe neni 31 i Kushtetutës, i obligon gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk mund të kuptohet si obligim i gjykatës për dhënë përgjigje të hollësishme në çdo argument të parashtruesit të kërkesës. (shih rastin e GJEDNJ-së *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994, Seria A. nr. 288, f. 20, paragrafi 61). Shkalla në të cilën zbatohet obligimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë sipas natyrës së vendimit. Ajo gjithashtu duhet të marrë parasysh, ndër të tjera, shumëllojshmërinë e parashtrësive të paraqitura nga një palë në procedurat që mund të bëjnë që gjykatat të japin mendime dhe përfundime të ndryshme ligjore gjatë marrjes së aktgjykimeve. Prandaj, pyetja nëse gjykata ka përmbushur detyrimin për të shpjeguar arsyet për vendimin e saj, që rrjedh nga neni 6 i Konventës, mund të përcaktohet vetëm në dritën e rrethanave të secilit rast individual.

58. Gjykata si rrjedhojë, konstaton se parashtruesi ka mundur të përfitojë nga një procedurë kontradiktore, ai ka mundur, në faza të ndryshme të procedurës, të paraqet pretendime dhe dëshmi që ai i konsideronte të rëndësishme për rastin e tij, kishte mundësi që të kundërshtonte në mënyrë efektive pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare, gjykatat e rregullta kishin dëgjuar dhe shqyrtuar të gjitha pretendimet e tij, të cilat, të shikuara objektivisht, konsideroheshin të rëndësishme për zgjidhjen e rastit, arsyet faktike dhe ligjore të vendimit të kontestuar ishin paraqitur në mënyrë të detajuar, prandaj procedurat, të marra si tërësi, ishin të drejta (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, paragrafët 29 dhe 30).
59. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, nuk është shkelur me vendimet e autoriteteve publike.
60. Duke marrë parasysh se parashtruesi i kërkesë dështoi të paraqesë prova, fakte dhe argumente që tregojnë se procedurat në gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata nuk do të lëshohet në shqyrtimin e pretendimeve të mëtejshme të parashtruesit të kërkesës për shkak se shkeljet e të drejtave të tjera të garantuara me nenet 24, 32 dhe 46 të Kushtetutës dhe të nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës i pretendon si pasojë e shkeljes së të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.
61. Gjykata rikujton se fakti i thjeshtë se parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e vendimeve të Gjykatës Supreme apo përmendja e neneve të Kushtetutës, nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (Shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese Aktvendim për papranueshmëri i 10 shkurtit 2015, *Abdullah Bajqinca*, KI136/14, paragrafi 33).
62. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, dhe rregullit 39 (2) të Rregullores së punës, më 27 maj 2019, njëzëri

### VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi